



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIËË BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr. 3050/23

Duke u bazuar në nenin 105 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05, L-068, si dhe Ligjin 05/ L-002, si dhe nenin 48 dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me spaleta ri-tender" me numër të prokurimit 214-23-12509-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, Kryetari i Paneli Shqyrtues Vedat Poterqoi më 29.02.2024, mori këtë:

KONKLuzion PËR NDRYSHIM TË VENDIMIT

Ndryshohet/ plotësohet Vendimi me nr. të protokollit 2023/3050, i datës 28.02.2024, që në faqen e parë të këtij vendimi konkretisht tek pika 1 dhe dispozitivit:

I. Aprovohet, si e bazuar kërkesa e Policisë së Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 27.12.2023, kurse OE "Creative Design" diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 1/një viti, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.08.2024, për shkak të prezantimit të dokumenteve të falsifikuara, vepër kjo e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datën 28.02.2024 ka publikuar vendimin me numër të protokollit 3050/23, me të cilin vendim ka diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 1/një viti, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.08.2024, për shkak të prezantimit të dokumenteve të falsifikuara, vepër kjo e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Ndryshohet/plotësohet me fjalinë si më poshtë:

I. Aprovohet, si e bazuar kërkesa e Policisë së Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 27.12.2023, kurse OE "Creative Design" diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 6/Muaj, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.08.2024, për shkak të prezantimit të dokumenteve të falsifikuara, vepër kjo e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Me rastin e përpilimit të Vendimit PSH. 2023/3050, i datës 28.02.2024, në faqen e pare është lëshuar një gabim teknik dhe me këtë rast edhe bëhen plotësimet e duhura sipas këtij Konkluzioni.

Sipas kësaj rezultati përfundimtar ka ndryshuar, vendimi i për diskualifikim në kohëzgjatje prej 1/viti ndryshohet (plotësohet) në kohëzgjatje prej 6/muaj.

Kryetari i panelit shqyrtues pasi që është njoftuar se në vendimin e lartcekur ka lëshime teknike, në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Procedure Administrative Ligji NT' 05/L -031, me anë të këtij konkluzioni bën korrigjimin e lëshimit duke vendosur si në dispozitiv të këtij konkluzioni,

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

